



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, më 12.09.2019

RAPORT PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR RATIFIKIMIN E KONTRATËS FINANCIARE, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EVROPIANE TË INVESTIMEVE, PËR PROJEKTIN “SHTRATI I LUMIT LANA – ZHVILLIM URBAN”

Hyrje

Të nderuar anëtarë/e të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut,

Në bazë të Kalendarit të Punimeve të Kuvendit dhe të kalendarit të punës së Komisionit, jam caktuar relator për projektligjin “Për Ratifikimin e kontratës financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të investimeve, për projektin “shtrati i lumit Lana – zhvillim urban”, për të cilin Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi.

Komisioni e shqyrton këtë projektligj në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës, sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Ratifikimi i kësaj marrëveshje bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kreu II “Marrëveshjet Ndërkombëtare”, neni 121 i saj.

II. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE PËRMBAJTJA E TIJ

Nëpërmjet këtij projektligji synohet ratifikimi i kontratës financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për projektin “Shtrati i lumit Lana – zhvillim urban”. Kredia që akordohet nëpërmjet kësaj kontrate ka shumën 8 milionë euro, maturimi për 20 vjet me interes të përcaktueshëm mbi bazën e tregut në momentin e disbursimit., duke përfshirë një periudhë pa pagesë principali prej 4 vjetësh. Për

bashkëfinancimin e këtij projekti BEI akordon, gjithashtu, edhe një grant në shumën 2,4 milionë euro.

Nëpërmjet këtij financimi synohet të realizohet zgjatimi i bulevardit nga Ura Teknologjike (ku përfundon aktualisht segmenti ekzistues) deri në kryqëzimin me rrugën “Teodor Keko” dhe rehabilitimin e shtratis të lumit Lana po për këtë segment. Nëpërmjet këtij projekti mundësohet krijimi i një shtrati me regjim hidraulik efeçent, për të eliminuar problematikën e përmytjeve në këtë zonë, si dhe krijimin e hapësirave të nevojshme të zhvillimit urban të zonës.

Rehabilitimi i lumit Lana në këtë segment dhe ndërtimi i zgjatimit të dy bulevardeve “Bajram Curri” dhe “Gjergj Fishta” do të ndikojnë pozitivisht në zhvillimin e kësaj zone, duke siguruar një infrastrukturë të qëndrueshme, e cila do t’i shërbejë edhe zonave përreth saj, duke përmirësuar gjendjen tejet të amortizuar të infrastrukturës ekzistuese.

Ngarkohen Bashkia e Tiranës dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij projektligji deri në shkurt të vitit 2022. Nisur nga plani i veprimit dhe i implementimit të këtij projekti, vlera e cila do të mbulohet nga shpenzimet buxhetore të Bashkisë Tiranë, do të jetë e shpërndarë në 3 vite buxhetore duke nisur që nga viti buxhetor aktual.

III. ÇËSHTJE PËR DISKUTIM

1. Në Komision u diskutua nëse Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka ndonjë të dhënë mbi kostot totale të parashikuara të projektit duke qënë se marrëveshja parashikon që efektet financiare të mbulohet nga shpenzimet buxhetore të Bashkisë Tiranë, e shpërndarë në 3 vite buxhetore duke nisur që nga viti buxhetor aktual. Përfaqësuesit e Bashkisë Tiranë konfirmuan se këto kosto janë reflektuar në projektbuxhetin afatmesëm (PBA).

IV. PËRFUNDIM

Në aspektin ligjor, vlerësoj se projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin proçedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Së fundi, si relator vlerësoj rëndësinë e miratimit të këtij projektligji dhe u kërkoj kolegëve ta miratojmë atë në Komision.

RELATORE

AURORA MARA

KRYETAR

ULSI MANJA